

Raporti vjetor 2013

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet



Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Dhjetor 2013

RAPORT

Mbi detyrat e realizuara për vitin 2013

Mbrojtja nga rrezatimet e publikut, personelit dhe mjedisit tani dhe për brezat e ardhshëm në Shqipëri është një proces në vazhdimësi, i cili kërkon një punë intensive të Zyrës për Mbrojtjen nga Rrezatimet dhe të gjithë atyre institucioneve, të cilët janë të lidhur me mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues. Përveç mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese gjatë 2013 ka nisur dhe procesi i pajisjes me akt miratimi I veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues. Stafi i ZMR-së ka punuar si çdo vit në zbatim të funksioneve që japin ligjet për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, ku misioni kryesor ka qënë të përgatisë dokumentat ligjore për mbrojtjen e punonjësve, publikut dhe mjedisit nga efektet e rrezatimeve duke zhvilluar dhe krijuar sistemin e administrimit dhe kontrollit të mbrojtjes nga rrezatimet, në përputhje me standartet ndërkombetare si të ANEA-s dhe EU-së.

Në këtë kuadër ka gjetur mbështetje dhe udhëzimi bazë për detyrat kryesore dhe objektivat e vitit 2013.

Detyrat kryesore për vitin 2013 ishin:

1. Mbledhje dhe sistemim i dokumentacionit për subjektet private dhe shtetërore, të cilët aplikojnë për marrjen e licensës, si dhe vlerësimi i tyre
2. Realizim inspektimesh në rang prefekturë, për subjektet të cilët nuk kanë plotësuar dokumentacionin për liçensim dhe vendosja e sanksioneve.
3. Inspektim subjektësh që u ka kaluar afati i liçensës dhe që përdorin burime të rrezatimit jonizues, vendosja e sanksioneve
4. Pjesëmarrje në projektet e ANEA-s.
5. Përshtatja e legjislacionit tonë me atë të BE-së dhe plotësimi i matricës ligjore.
6. Bashkëpunim me departamentin e promocionit të ISHP për fillimin e një serie broshurash për promovimin e aktivitetit të zyrës dhe shpërndarjen e tyre në rang Republike.
7. Përditësimi i inventarit kombëtar i të gjithë burimeve të rrezatimit jonizues në RSH dhe plotësimi i rubrikave të sistemit RAIS bazuar në liçensimin, inspektimin, import-eksportin dhe transportin e burimeve të rrezatimit jonizues.
8. Instalimi i RAIS në version SQL
9. Fillimi i procedurave për sistemimin e programit SAT mbi vetëvlerësimin e trupës rregullatore.
10. Rishikim sipas raportit të vlerësimit nga ana e ANEA-s në lidhje me planin për përgatitjen dhe përballimin e emergjencave radiologjike .
11. Rritje e nivelit tonë shkencor profesional nëpërmjet kualifikimeve të ndryshme, seminareve apo trajnimeve për të qënë sa më eficientë në punën tonë të përditshme dhe pjesëmarrje në projektet që kemi në rang ndërkombëtar.
12. Miratimi nga KMR i dokumentit mbi “Politikat kombetare për trajtimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”.
13. Realizimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit.

14. Përgatitja e metodologjisë për llogaritjet e fushave elektromagnetike si dhe miratimi i udhëzuesit të pagesave.
15. Nisja e procesit për pajisjen me akt miratimi të burimeve të rrezatimit jojonizues.
16. Krijimi i një inventari të burimeve të rrezatimit jojonizues
17. Përditësimi i të dhënave në sitemin RASIMS në muajt shkurt 2013 dhe shtator 2013.
18. Përcaktimi i politikave dhe strategjive kombëtare për edukimin dhe trajnimin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.
19. Përditësimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
20. Mbledhja e të dhënave dhe sistemim i informacionit në lidhje me trafikun ilegal

Matrica ligjore e parashikuar për Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet për vitin 2013

Përgatitja e metodologjisë për llogaritjet e fushave elektromagnetike si dhe miratimi i udhëzuesit të pagesave. KMR

Katërmujori i parë

Hartimi dhe miratimi i dokumentit “Politika Kombetare per trajtimin e mbetjeve radioaktive ne Republiken e Shqiperise” KMR

Katërmujori i parë

Projektvendim per “Rregullore për përcaktimin e e standarteve bazë në instalimet radiologjike diagnostike në mjekësi”

Katërmujori i dytë

Rishikim i Planit të përgatitjes dhe reagimit ndaj emergjencave radiologjike duke përfshirë dhe informimin e publikut. Kjo duke marrë në konsideratë dhe rekomandimet e ANEA-s nga misioni i verifikimit në Nëntor 2011. Katërmujori i tretë

Në mbështetje të planit të punës për vitin 2013, ku janë të përcaktuara detyrat kryesore dhe objektivat bazë, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka realizuar detyrat e përcaktuara me përpikmëri. Këto detyra lidhen me pranimin e dokumentacionit të aplikuesve për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues dhe jojonizues; vlerësimi i aplikimeve për këto veprimtari, inspektimi i kabineteve radiologjike dhe subjektet që përdorin burime të hapura dhe të mbyllura në Republikën e Shqipërisë; aprovimet e import/eksportit, transportit

dhe transferimit të burimeve të rrezatimit jonizues, plotësimi i kuadrit ligjor dhe përafrimi i tij me direktivat e EU si dhe standartet e ANEA-s etj.

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga rrezatimet” Nr.8025, datë 9.11.1995, i ndryshuar dhe ligjit Nr.10469 datë 13.10.2013, shtyllat bazë ku mbështetet puna jonë janë, Liçensimi i veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, pajisja me akt miratimi i veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, Inspektimi i subjekteve që kanë në përdorim burime të rrezatimit jonizues dhe Sanksionet në rastin e shkeljeve të dispozitave ligjore.

-LIÇENSIMI I VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMIT JONIZUES

Në zbatim të ligjit Nr.8025 datë 09/11/1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar si dhe rregullores mbi “Licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues” Nr.10 datë 07/01/2010, procesi i licensimit ka vazhduar normalisht dhe gjatë këtij viti, që nga e faza e parë që është njoftimi e deri në fazën e fundit që është miratimi ose jo i liçensës.

Janë miratuar nga KMR 12 liçensa, nga të cilat 9 janë liçensa të reja, 1 është rinovim liçense, ndërsa 2 subjekte kanë amenduar liçensën. Liçensat e miratuara nga KMR për këtë vit janë si më poshtë:


- 1-Kompania “Apave Albania” Sh.p.k (radiografi industriale me rreze X dhe grafi industriale me burim Ir-192)
- 2- Subjekti “Ceci Dent” Sarandë (Panoramex dhe grafi dentare)
- 3-Subjekti B&T Sistem (import i gjeneratorëve me rreze X)
- 4-Subjekti “Posta Shqiptare, Filiali Qendra Tranzite” (Skaner i sigurisë)
- 5-Amendimi i licencës për subjekti “Klinika Orthodoxe e Ungjillizmit”
- 6- Amendimi i licencës për Qendrën e Radioterapisë në QSUT (Co-60)
- 7-Subjekti Best Theratronics
- 8-Subjekti Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitali 5, Shërbimi i Neurokirurgjisë (Akselerator Linear, CT- Simulator dhe burim kalibrimi Sr-90)
- 9-Kabinet Stomatologjik “Oasis” , Tiranë (grafi dentare)
- 10-Laborator Imazherie “Radiology Center”, Sarandë (Grafi, mamografi dhe grafi dentare)
- 11-Kompania Albchrome sh.p.k (burim i mbyllur radioaktiv Cs-137)
- 12-Klinika Aesthetic Density Brianza Dent(grafi dentare dhe panoramex)

Në tabelën 1, është bërë një shpërndarje e burimeve të rrezatimit jonizues, sipas aparaturave me rreze X, burimeve radioaktive të mbyllura dhe të hapura, të cilat përdoren nga subjekte të ndryshme në fushën e mjekësisë, industrisë apo edukimit dhe shkencës, të cilat janë liçensuar gjatë 2013.

Burimi i rrezatimit jonizues	Grafi	CT-Simulator	Akselerator	Grafi dentare & panoramex	Grafi industrial me rreze X	Burim i mbyllur Kat I	Burim i mbyllur kategori II, IV dhe V	Mamografi	Import gjeneratore me rreze X	Skaner i sigurise
Nr.	1	1	1	5	1	1	3	1	1	1

Tabela 1

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike burimet e rrezatimit jonizues të liçensuar gjatë vitit 2013.



Grafik 1



Grafik 2

Në grafikun 2 është paraqitur ne përqindje nr i licensave të miratuara gjatë viteve, 2011, 2012 dhe 2013.

PAJISJA ME AKT MIRATIMI I VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMIT JOJONIZUES

Në zbatim të ligjit Nr.10 469 date 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet është autoriteti përgjegjës kombëtar rregullator, që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet përcakton masat e nevojshme për të siguruar, në çdo rast, që ekspozimet e çdo instalimi ose pajisjeje, që emetojnë rrezatim jojonizues, të jenë në përputhje me normat e miratuara nga rregulloret përkatëse. Në zbatim të ligjit të mësipërm dhe VKM Nr.743, datë 16.10.2012, “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”, për momentin bën vetëm vlerësimin nëse rrezatimi jojonizues ka ndikim tek publiku. Në lidhje me vlerësimin e ekspozimit të punonjësve të angazhuar në punë me këto rrezatime do të nisë në momentin e miratimit të rregullores për mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht.

Gjatë 2013 KMR miratoi dokumentin Nr.822/2 datë 13.02.2013, mbi “Metodën e llogaritjes së përmasave të Zonës Kritike të shperhapjes së rrezatimit të një antene celulare”, si dhe udhëzuesin Nr.176 datë 04.04.2013 “Për miratimin e tarifave për pajisjen me akt miratimi për veprimtaritë me burime të rrezatimit jojonizues”. Me plotësimin e kuadrit ligjor, procesi për pajisjen me aktin e miratimit të stacioneve bazë ka filluar në muajin Maj 2013. Deri tani janë pajisur me akt miratimi 123 stacione bazë të kompanisë Vodafon Albania dhe gjithashtu janë në proces vlerësimi 60 stacione bazë të kompanisë AMC dhe 30 stacione të tjera të Kompanisë Vodafon. Në ZMR gjatë 2013 është krijuar dhe inventari në mënyrë elektronike i të gjitha Btacioneve Bazë të pajisura me akt miratimi nga KMR. Gjatë 2014 do të punohet për fazën e dytë të këtij procesi

që janë inspektimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues si dhe realizimi i matjeve.

Në zbatim të udhëzuesit të miratuar nga KMR “Elementët për njohje nga ana e KMR-së për personat juridikë dhe fizikë që kryejnë matje me rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, kalibrim të pajisjeve radiometrike dhe matëse të rrezatimeve, trajnime dhe shërbim të dozimetrisë personale” Nr.1526/1 datë 13.04.2012, kompani të ndryshme kanë aplikuar pranë ZMR për njohjen e tyre nga KMR dhe kryerjen e matjeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues. kalibrim të pajisjeve dhe trajnime, pranë ZMR kanë aplikuar disa subjekte, të cilët janë njohur nga KMR, si me poshtë:

- 1-Kompania Ekoteh Albania, e cila do të kryejë matje të rrezatimit jonizues.
- 2-Instituti i Mbrojtjes nga Rrezatimet, i cili do të kryejë trajnime në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet
- 3-Instituti i Rrezatimeve, i cili do të kryejë trajnime në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet si dhe do të kryejë vlerësime në lidhje me rrezatimet jojonizuese.

-INSPEKTIMI I SUBJEKTEVE QË USHTROJNE VEPRIMTARI ME BURIME TE RREZATIMIT JONIZUES

Në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2013 është kryer pjesa më e madhe e inspektimeve të planifikuara.

Gjatë 2013 janë realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive. Për kryerjen e inspektimeve janë vënë në dispozicion nga laborantja e ZMR-së, të gjitha pajisjet e nevojshme dhe janë realizuar matje në lidhje me fuqinë e dozës në ambientet publike si dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues.

Inspektimet e realizuara gjatë 2013:

Subjekte Shtetërore:

- 1- Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Tiranë
- 2- Qendra e Mjekësisë Bërthamore, QSUT
- 3- Spitali Rajonal, Lushnjë
- 4- Spitali Rajonal, Fier
- 5- Spitali Rajonal, Vlorë
- 6- Spitali Rajonal Lezhë
- 7- Spitali Rajonal Shkodër
- 8- Spitali rajonal Korçë
- 9- Spitali Rajonal Pogradec
- 10-Spitali Rajonal Ersekë

- 11-Spitali Rajonal Devoll
- 12-Spitali Rajonal Pukë
- 13-Spitali Rajonal Tropojë
- 14-Spitali Rajonal Kukës
- 15-Spitali Rajonal Rubik
- 16- Spitali Rajonal Rrëshen
- 17- Spitali Rajonal Has
- 18- Spitali Rajonal Berat
- 19- Spitali Rajonal Kucovë
- 20- Spitali Rajonal Skrapar
- 21- Spitali Rajonal Durrës
- 22- Spitali Rajonal Kavajë
- 23-Qendra Shëndetësore Shijak

Shënim: Inspektimi në këto rrethe përfshin dhe poliklinikat, dispanceritë apo cdo qendër shëndetësore që ka në përdorim burime të rrezatimit jonizues.

Subjekte Private:

- | | |
|--------------------------------------|---|
| 1- Klinika "Egian " | 30-Klinika veterinare "Shtëpia e kafshëve të vogla" |
| 2- Tirana Diagnostic Center | 31-Klinika veterinare "Oasis" |
| 3- Klinika Juli, Panoramex | 32-Spitali kirurgjik Austriak |
| 4- Klinika Julian Sefa,
Panoramex | 33-Klinika Mat Dental |
| 5- Klinika Xhaferi | 34-Klinika Target Albania |
| 6- Klinika "Tasha &Lola" | 35-Spitali Veterinar Sauk |
| 7- Klinika Joana | 36-Klinika dentare Entela Zaimi,
Sauk |
| 8- Klinika Vera Nikolli | 37-Klinika dentare Laureta Koci |
| 9- Klinika Sulaj | 38-Klinika dentare Shahin Joka |
| 10-Klinika Studio red Nene
Tereza | 39-Grafi dentare Nr.1 |
| 11-Klinika Smile | 40-Ana Diagnostic Center |
| 12-Klinika Simon Cela | 41-Klinika Brillant |
| 13-Klinika Neë Smile | 42-Klinika Daimond Dental |
| 14-Klinika Universal | 43-Klinika Memo Dental |
| 15-Klinika Eda | 44-Klinika Bujar Methasani |
| 16-Klinika buzeqeshja | 45-Klinika Kristal dental |
| 17-Klinika Eliadent | 46-Klinika Hysa, Kamëz |
| 18-Klinika Smile(ish 17 Nentori) | 47-Klinika Endedent |
| 19-Klinika Dental Planet | 48-Radiografi dentare Geri |
| 20-Klinika Eva Dent | 49-Klinikë dentare Kamëz |
| 21-Panoramex Duka | 50-Klinikë dentare turke "Dipen" |
| 22-Klinika Real Dent | 51-Klinika Blu dent |
| 23-Klinika Rapi Rushi | 52-Klinika Brillant Dent,
Kombinat |
| 24-Klinika Eva Baboci | 53-Klinika dentare "P. Dautaj" |
| 25-Klinika veterinare "Pet life" | 54-Klinika "Rein Dental" |
| 26-Klinika Eli Steriopullo | 55-Klinika dentare Sako |
| 27-Klinika Dent Estetik | 56-Klinika dentare Stamboll |
| 28-Klinika Toti & Gurakuqi | |
| 29-Klinika Class Dental | |

Në grafikun 3 është paraqitur nr i inspektimeve të kryera në subjektet private dhe shtetërore gjatë vitit 2013.



Grafik 3

Më poshtë paraqitet me grafik nr i inspektimeve të kryera gjatë 2013, karahasuar me vitet 2012 dhe 2011.



Grafik 4

-IMPORT-EKSPORTI I BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES

Proçesi i import –eksporteve të materialeve radioaktive ka funksionuar mbështetur në VKM për import-eksportet në Republikën e Shqipërisë, Nr.158 datë 13/02/2008, udhëzuesin mbi import-eksportin, tranzitin e burimeve radioaktive të kategorive 1 dhe 2 në Republikën e Shqipërisë Nr.134, date 12/04/2011 dhe rregulloren për “Import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive”, Nr.3918/4, datë 3/11/2004.

Gjatë vitit 2013 janë dhënë 141 aprovime importi. Gjatë këtij viti janë kryer kryesisht importe të burimeve radioaktive të mbyllura, të përfshira në grupin e sigurimit A,B,C dhe D si dhe burime të hapura radioaktive të cilat kryesisht përdoren për ekzaminime “in Vitro” dhe “in Vivo”.

Për sa i takon eksporteve, gjatë 2013 janë eksportuar 1 burim i kategorisë së I-rë Co-60, i cili është përdorur nga Qendra e Radioterapisë për trajtimin e pacientëve me kancer, si dhe 7 burime Cs-137 (kategori V) dhe 2 gjeneratore neutronike (kategori IV), të cilat janë përdorur nga kompania Schlumberger në industrinë e naftës. Eksporti është kryer sipas kontratave të nënshkruara për kthimin e burimeve radioaktive tek prodhuesi në fund të jetës së tij. Kthimi i burimit tek prodhuesi në fund të përdorimit ka qënë një nga strategjitë e punës tonë në mënyrë që të krijohen sa më pak mbetje në vend.


Më poshtë është paraqitur një shpërndarje e importeve dhe eksporteve të kryera gjatë vitit 2013 në mënyrë tabelore dhe grafike.

Nr i aprovimeve mbi importin e burimeve të rrezatimit jonizues


Medicare	Univers Alb	Neo Style	Domi	Hygeia Hospital	QSUT	Schlumberger	Albchrome QFBZ	
26	26	14	1	38	32	2 eksport	1	1

Tabela 2

Në grafikun 5 është paraqitur një shpërndarje e aprovimeve për import të burimeve të rrezatimit jonizues sipas kompanive të licensuara, të dhëna gjatë vitit 2013



Grafik 5



Grafik 6

Në grafikun 6 është paraqitur nr i import-eksporteve të miratuara gjatë vitit 2013 krahasuar me import-eksportet e kryera gjatë 2011 dhe 2012.


-TRANSPORTI I BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES

Transporti në Republikën e Shqipërisë kryhet nga subjekte të licensuar nga KMR dhe që zbatojnë të gjitha dispozitat e rregullores për “Transportin e sigurtë të materialeve radioaktive” Nr.488 datë 23.06.2010, si dhe të gjitha dispozitat e tjera që lidhen me transportin. Kompani të licensuara për kryerjen e transportin janë Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, e cila është dhe e vetmja qendër e licensuar për kryerjen e transportit për të tretë, gjithashtu janë të lincsuara Qendra diagnostikuese Medicare dhe Hygeia Hospital, të cilët janë të detyruar të kryejnë transport vetëm për interesa të kompanisë së tyre dhe jo për të tretë.

Në lidhje me aprovimet e lëshuara nga ZMR për transportin, gjatë kësaj periudhe janë dhënë 143 aprovime transporti për burime të hapura dhe të mbyllura, nga të cilat 139 janë transport për burime të hapura, të cilat përdoren në mjekësi për diagnostikimin dhe terapinë e pacientëve, ndërsa 4 prej tyre janë aprovime transporti për burime të mbyllura radioaktive , të cilat përfshihen në grupin e sigurimit A, B, C dhe D si dhe përdoren në fushën e mjekësisë dhe industrisë. Më poshtë po paraqesim një shpërndarje në mënyrë tabelore dhe grafike të aprovimeve të dhëna për këtë vit.


Nr.i aprovimeve për transportin	
Medicare, QFBZ, Hygeia Hospital Burime të hapura	Qendra e Fizikës Bërthamore e Zbatuar, Hygeia Hospital, burime të mbyllura
138	5

Tabela 3



Grafik 7


Në grafikun 8 është paraqitur në përqindje nr i aprovimeve për transport të dhëna për vitin 2013 të krahasuara me vitin 2011 dhe 2012



Grafik 8

SANKSIONET

Në zbatim të udhëzimit Nr. 676 datë 05.12.2008 “Për shkallën e penalizimit për shkeljet administrative të parashikuara në ligjin nr.8025 datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimi”, i ndryshuar, gjatë vitit 2013 janë plotësuar 56 Proces-Verbale dhe 7 Vendime për disa subjekte private, për shkak të shkeljeve të dispozitave të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit të cituar më sipër.



Grafik 9

-MBLEDHJET E KOMISIONIT TË MBROJTJES NGA RREZATIMET

Gjatë këtij viti janë realizuar 6 mbledhje të KMR ku janë marrë disa vendime.

18 Janar 2013

KMR miratoi:

- Plani i punës së ZMR dhe drejtimet kryesore të punës për vitin 2013
- Grafikun e inspektimeve për vitin 2013
- dokumentin mbi „Procedurat e vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese“.
- dokumentin mbi „Metodologjinë e llogaritjes së përmasave të Zonës Kritike të shpërhapjes së rrezatimit të një antene celulare“.

KMR njohu si fizikan mjekësor punonjëset e QSUT-së:

1. Znj.Lulëzime Daci
2. Gentiana Hysaj
3. Ortesa Dhima
4. Rodina Myrku Cela

KMR njohu si ekspert i kualifikuar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet dhe Z.Bardhyl Grillo

4 Shkurt 2013

Në këtë mbledhje është diskutuar mbi çështjen e ngritur në Komisionin Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Energjisë dhe Tregëtisë, lidhur me ndryshimet e ligjeve sektoriale në përputhje me Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ku deputetë të ndryshëm ishin shprehur për ndryshime në ligjet tona bazë, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, Nr.8025, datë 9.11.1995, i ndryshuar si dhe ligjit “ Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” Nr.10469 date 13.10.2011

Gjatë kësaj mbledhje u ngrit një grup pune për të marrë pjesë në seancën dëgjimore në Komisionin Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Energjisë dhe Tregëtisë. Grupi përbëhej nga anëtarët e KMR-së si më poshtë.

1. Rustem Paci
2. Nikolla Civici
3. Kostandin Dollani
4. Përparim Fuga

Anëtarët e KMR mbrojtën me argumenta duke u bazuar dhe në rekomandimet e IAEA-së se ndryshimet që pretendoheshin nga një grup deputetësh ishin të panevojshme dhe se nuk kishte asnjë mbivendosje në lidhje me Ligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

12 Mars 2013

KMR mbështetur në matricën ligjore 2013 miratoi në këtë mbledhje:

Dokumentin mbi “Politikat për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”.

Miratimi në parim i rregullores mbi “Përcaktimin e standarteve bazë për kontrollin teknik të pajisjeve mjekësore”. Në këto moment rregullorja është dërguar për mendim ministrive të linjës.

Në zbatim të ligjit Nr. 10.469 datë 13.10.2011 “ Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, KMR miratoi udhëzuesin mbi tarifatat e akteve të miratimit për të ushtruar veprimtari me burime të rrezatimit jonizues,

Tarifimi është llogaritur për cdo stacion bazë dhe jo për cdo burim të rrezatimit jonizues.

Në zbatim të dokumentit mbi “Procedurat e vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, KMR njohu si ekspert të kësaj fushe:

- 1-Z.Shkëlqim Mema
- 2-Z.Albert Noçka
- 3-Z.Rustem Paci

Në vijim për sa më sipër u propozua se personat të cilët, fitojnë statusin e ekspertit të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jonizuese, të mos e aplikojnë për sa kohë janë anëtarë të KMR-së, ose të japin dorëheqje si anëtar i këtij komisioni, duke qënë se krijon konflikt interesi, veprim i cili është ndërmarrë kohë më parë nga Z.Rustem Paci, i cili dhe pse gëzon statusin e ekspertit në këto fusha nuk e aplikon për sa kohë është sekretar i KMR.

KMR miratoi në këtë mbledhje licensën e Kompanisë “Apave Albania Sh.p.k” me përfaqësues Z.Kreshnik Strati, i cili do të kryejë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues (radiografi industriale me rreze X dhe burim radioaktiv Ir-192).

13 Maj 2013

KMR miratoi licensat si më poshtë:

1. Subjekti “Ceci Dent” Sarandë
2. Subjekti B&T Sistem
3. Subjekti “Posta Shqiptare, Filiali Qendra Tranzite”
4. Amendimi i licencës për subjekti “Klinika Orthodokse e Ungjillizmit”, KMR diskutoi për pajisjen me licencë të këtij subjekti. Licensa do ti jepet pasi stafi të të paraqesë dëshmitë e kualifikimet me kursin përkatës për mbrojtjen nga rrezatimi.
5. Amendimi i licencës për spitalin onkologjik të jepet pasi të bëhet dhe njëhereë rivlerësim për ekspertizën.
6. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitali 5, Shërbimi i Neurokirurgjisë
7. Subjekti Best Theratronics

Miratimi i 30 Stacioneve Bazë për kompaninë Celulare Vodafon Albania

Në zbatim të dokumentit mbi “Procedurat e vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, Në mbledhjen e kësaj date KMR njohu si ekspert të kësaj fushe:

1. Institutin e Rrezatimit .

Gjithashtu, sipas procedurave të përcaktuara në dokumentin nr.4629/1 prot, dt. 1.11.2012 të miratuar nga KMR “Udhëzim mbi procedurat e vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si fizikan mjekësor”, KMR njohu si ekspert të kësaj fushe:

1. Znj.Drilona KISHTA
2. Znj. Erjona BAKIU
3. Z. Ervis TELHAJ

Shtimi i disa elementëve të rëndësishëm në dokumentin mbi “Procedurat e vlerësimit të aplikimit për pajisje me akt miratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues” si më poshtë:

- Të jepet një përshkrim i saktë i pozicionit dhe objekteve rreth stacionit që të përfshijë distancat dhe katet e objekteve. Ky përshkrim të jepet në një planimetri, format A3 dhe në një shkallë 1:200.
- Materiali i dorëzuar duhet të firmoset si nga ekspertiashtu edhe nga përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë, si edhe të siglohet në cdo faqe. Eksperti duhet të përcaktojë saktë sa është lartësia e pikës mbi të cilën janë bërë kalkulimet.
- Eksperti duhet të shprehet qartë dhe në lidhje me cele të afërta nqs ka, të së njëjtës kompani apo kompanive të tjera që ndërhyjnë në vlerësim.
- Të përcaktohet terminologjia d_1 dhe d_{2d}
- Mosdeklarimi i të dhënave të sakta është përgjegjësi e kompanisë.

Në mbledhjen e kësaj date u mor vendim që Nr. i aplikimeve nga kompanitë celulare, të cilat do të pranohen në ZMR të jetë 30 stacione në muaj.

Gjithashtu u kërkua mbështetje nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me sigurimin qoftë dhe të një pajisjeje për të kryer matje të rrezatimit jojonizues, e cila është shumë e domosdoshme për të filluar implementimin e kuadrit ligjor në këtë fushë.

26 Korrik 2013

KMR miratoi aktin e miratimit për 41 Stacione Bazë të kompanisë Vodafon Albania

KMR miratoi licensat për subjektet e mëposhtëm:

1-Kabinet Stomatologjik “Oasis” , Tiranë (grafi dentare)

2-Laborator Imazherie “Radiology Center”, Sarandë (Grafii, mamografi dhe grafii dentare)

Njoftimi i anëtarëve të komsionit në lidhje me importin e burimit të ri të Co-60 si dhe eksportin e burimit të vjetër ekzistues. Në lidhje me këtë proces janë plotësuar të gjitha procedurat për import-eksportin si dhe transportin e burimit të ri dhe të vjetër të Co-60.

Memorandumet e mirkuptimit me shtetet , Kosovë, Greqi dhe Bosnjë Hercegovinë.

Gjatë muajit korrik të këtij viti u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Trupës Rregullatore në Kosovë, ku si qëllim kryesor i takimit ishte firmosja e memorandumit të mirkuptimit midis dy shteteve, në mënyrë që më pas të nisë dhe bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizues.

18 Tetor 2013

KMR miratoi 52 Stacione Bazë për kompaninë Vodafonë Albania.

Ngritja e grupit të punës për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për trajtimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë. Grupi i punës që do të punojë për përgatitjen e këtij dokumenti do të përbëhet nga anëtarët si më poshtë:

- 1-Rustem Paci
- 2-Kostandin Dollani
- 3-Nikolla Civici
- 4-Luan Qafmolla
- 5-Shkëlqim Mema

KMR miratoi licencat e reja për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues:

- 1- Kompania Albchrome sh.p.k (burim i mbyllur radioaktiv Cs-137)
- 2- Klinika Aesthetic Densitry Brianza Dent (grafi dentare dhe panoramex)

Amendim i procedurave për vlerësimin e aplikimit për pajisje me akt miratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues.

Në zbatim të rregullores Nr.743 datë 16.10.2012 “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese, KMR mori vendim që eksperti në vlerësimin e tij, në lidhje me stacionet bazë të instaluara, të deklarojë që nuk ka mbivendosje nga celet dhe mastet e tjera në zonen e tyre të llogaritjes të fushës kritike. Kjo pikë do të reflektohet dhe në dokumentin mbi “ Procedurat e vlerësimin të aplikimit për pajisje me akt miratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues” Nr.2651/1 prot, datë 20.05.2013.

Me qëllim lehtësimin e procedurave për licencimin e grafive dentare në unit. KMR miratoi formatin e aplikimit për radiografite dentare në unit. Formatin është reduktuar në kërkesat e tij, gjë e cila e lehtëson mjaft përdoruesin e këtyre pajisjeve me rreze X për përdorim personal. Kjo pa kompromentuar sigurinë e publikut dhe të punonjësve

Krijimi i grupit të punës për përgatitjen e strategjisë mbi inspektimin e burime të rrezatimit jojonizues u ngrit me përfaqësues si më poshtë:

- 1-Rustem Paci
- 2-Kostandin Dollani
- 3-Nikolla Civici
- 4-Shkëlqim Mema
- 5-Përparim Fuga

MATERIALE TË MIRATUARA GJATË 2013 NGA KËSHILLI I MINISTRAVE DHE KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

1-Vendim Nr.229 datë 20.03.2013 i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores mbi “ Sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues”

Materialet e miratuara nga KMR si më poshtë:

1-Dokumenti mbi “Politikën për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë” Nr. 1319/3 date 25.03.2013

2-Dokumenti mbi “Metodën e llogaritjes së përmasave të Zonës Kritike të shperhapjes së rrezatimit të një antene celulare” Nr.822/2 datë 13.02.2013

3-Udhëzues Nr.176 datë 04.04.2013 “Për miratimin e tarifave për pajisjen me akt miratimi për veprimtaritë me burime të rrezatimit jojonizues”.

4- Dokumenti mbi “ Procedurat e vlerësimit të aplikimit për pajisje me akt miratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues” Nr.2651/1 prot, datë 20.05.2013.

5- Formati i aplikimit për radiografitë dentare në unit

6-Miratimi në parim i rregullores mbi “Standartet bazë në instalimet radiologjike diagnostike në mjekësi”. Është përgatitur drafti final dhe është dërguar për mendim në ministrinë e linjës. Pasi të reflektohen dhe mendimet e ministrive të linjës, rregullorja do të dërgohet për miratin në Këshillin e Ministrave.

PLANI KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT (PKMZSA)

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet edhe gjatë këtij viti ka punuar për përshtatjen e legjislacionit shqiptar, që përfshin mbrojtjen nga rrezatimi me legjislacionin europian në kuadër të integritit të Shqipërisë në Europë. Detyrimet që duhet të përmbushë Shqipëria reflektohen në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKMZSA), që është instrumenti bazë i procesit të Integritit Europian.

Gjatë këtij viti është siguruar pjesëmarrja në takimet e Nënkomitetit BE-Shqipëri për “ Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal”, si dhe janë përgatitur raportet përkatëse.

- Raportimet për progresin e arritur për PKZMSA të dërguara pranë MSH dhe MIE në shqip dhe anglisht (Raporti 3 mujor Prill-Qershor 2013, Drafti i dytë i Raport Progresit Gusht 2013).

Përzgjedhje e direktivave europiane për transpozimin në legjislacionin shqiptar në bashkëpunim dhe me zyrën e Integritit dhe IPA në DBEM në MSH.

Takim me specialisten e Ministrisë së Integritit për programin TAIEX pranë ZMR.

Përgatitja e draft materialit në takimin e katërt të KSA të zhvilluar në Tiranë.

Përgatitja e materialit për takimin e Brukselit- Nënkomiteti BE-Shqipëri mbi “Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal”.

BAZA E TË DHËNAVE MBI TRAFIKUN ILEGAL

Shqipëria është përfshirë në sistemin e Bankës së të Dhënave për Trafikun Ilegal (BDTI) të lëndëve radioaktive pranë Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA). ZMR ka vazhduar punën për mbledhjen e të dhënave dhe sistemin e këtij lloj informacioni edhe me formatin e ri që ka nxjerre Agjensia. Informacioni i marrë arkivohet pranë ZMR i kategorizuar sipas burimeve radioaktive.

USHTRIME NË LIDHJE ME EMERGJENCAT RADIOLOGJIKE

Është kryer regjistrimi në faqen e Internetit të ANEA-s (Qendra e Aksidenteve dhe Emergjencat) dhe është siguruar pjesëmarrja në ushtrime të ndryshme, gjatë vitit 2013 si më poshtë :

Ushtrimi i përvitshëm ConvEx-1c

Ushtrimi ConvEx-2b, Qershor 2013

Ushtrimi ConvEx-3, Nëntor 2013

RASIMS

RASIMS(Sistemi i Menaxhimit të Informacionit mbi Sigurinë nga Rrezatimi) është një platformë që mundëson Shtetet Anëtare dhe Sekretariatit e IAEA të mbledhin së bashku, të analizojnë dhe të kontrollojnë informacionin në lidhje me infrastrukturën kombëtare, për mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë e mbetjeve radioaktive. Përveç lehtësimit të identifikimit të nevojave kombëtare dhe rajonale, informacioni në RASIMS përdoret dhe për një sërë qëllime të tjera, duke përfshirë ketu dhe bashkëpunim në projekte të ndryshme që lidhen me procesin e mbrojtjes, sigurisë dhe sigurimit nga burimet e rrezatimit jonizues. Informacioni në RASIMS është i grupuar në Thematic Safety Areas(TSA) si më poshtë:

TSA1 - Regulatory Infrastructure

TSA2 - Radiological Protection in Occupational Exposure

TSA3 - Radiological Protection in Medical Exposure

TSA4 - Public and Environmental Radiological Protection

TSA5 - Emergency Preparedness and Response

TSA6 - Education and Training in Radiation, Transport & Waste Safety

TSA7 - Transport Safety (e re)

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet është pjesë e këtij sistemi dhe është përgjegjëse për plotësim dhe azhurnim të informacionit nëse ka, cdo gjashtë muaj, për TSA 1, TSA4 dhe TSA6.

Gajtë muajit shkurt është përditësuar informacioni në lidhje me TSA 1 mbi Infrastrukturën Regulatorë .

RASIMS TSA 1

Në muajin Maj 2013 është përditësuar informacioni në lidhje me TSA4, Mbrojtja e Publikut dhe Mjedisit nga Ekspozimet Radiologjike

RASIMS TSA4

Në lidhje me TSA6, është në proces rishikimi i Planit të përgatitjes dhe reagimit ndaj emergjencave radiologjike. Rishikimi i këtij plani do të marrë në

konsideratë dhe rekomandimet e ANEA-s nga Misioni i verifikimit në Nëntor 2011. Pasi të përfundojë ky proces do të hidhet informacioni në sistem.

SEMINARE, TAKIME DHE TRAJNIME

Është siguruar pjesëmarrja në seminare e takime të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, sic mund të përmendim:

- a. Takim “Mbi zbatimin e Kodit të Drejtimit për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioactive”, Mars 2013, Tiranë.
- b. Kurs rajonal mbi “Nuclear security detection architecture”, 13-17 Maj 2013, Athinë, Greqi.
- c. Takim mbi “Implementimin e planit mbi konceptin e vendosjes së burimeve në pus”, 7-11 Tetor 2013 Tiranë
- d. Takim Rajonal mbi “Bashkëpunimin dhe implementimin e një sistemi model për menaxhimin e mbetjeve radioaktive”, 25- 29 Mars 2013, Bosnje Herzegovine, Sarajeve
- e. Seminar Nderkombetar mbi “Elementet esenciale për sigurinë berthamore” 13-24 Maj 2013, Argonne, Illinois, USA
- f. Takim rajonal mbi “ Kontrollin rregullator të shkarkimeve të materialeve radioaktive në mjedis” 17-21 Qershor 2013, Varshave, Poloni
- g. Takim Ndërkombëtar mbi “Implementimi i planit mbi konceptin e vendosjes se mbetjeve radioaktive ne pus” 7-11 Tetor 2013 Tiranë
- h. Konferenca ndërkombetare mbi “ Trafikun Ilegal ne Rajonin e Detit të Zi”, 7-8 Nëntor 2013, Chisinau, Moldavi

ADMINISTRIMI

1. Gjatë vitit 2013, janë regjistruar në inventarin elektronik

-141 aprovime importi- eksporti

-143 aprovime transporti

- Subjektet e licensuara për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, -

Subjektet e licensuara për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues -271 stacione bazë të antenave celulare (numri i sb, emërtimi, kordinatat, adresa)

-Subjektet e inspektuara në tiranë

-Shkresë- ankesat e ardhura në ZMR

-Subjektet e pa licensuara (dërguar nga dshp e rretheve)

2-Në librin e protokollit për vitin 2013 janë regjistruar 50 shkresa të ardhura në ZMR dhe 132 shkresa të dërguara nga ZMR.

Shkresat e ardhura në ZMR gjatë vitit 2013

Tematika në lidhje me shkresat e ardhura në ZMR ka qenë korespondenca me IAEA, kërkesa të ndryshme për t'u paisur me licensë, amendim license, informacione në zbatim të ligjeve “ Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ” dhe “ Për nga rrezatimet jo jonizuese ”, informacion në lidhje me tarifat për paisje me akt miratimi, aktmarveshje, kërkesa për eksport të burimeve të

rrezatimit jonizues , ankesa nga avokati i popullit, si dhe ftesa për pjesëmarrje në trajnime.

Pjesë e letrave të ardhura në ZMR kanë qënë dhe ankesat nga banorët në lidhje me vendosjen e antenave të kompanive celulare në: Tiranë, Lezhë dhe Shkodër.

Shkresat e dërguara nga ZMR gjatë vitit 2013

ZMR ka dërguar 131 shkresa zyrtare ku tematika kryesore ka qënë

1. Ftesa institucioneve për pjesmarrje në takime të organizuara në ZMR .
2. Ftesa për pjesmarrje në ëorkshope, të organizuara në Tiranë nga IAEA, për pjesmarrësit jashtë Shqiperisë.
3. Kërkesë për bashkëpunim me DSHP-të e rretheve,
4. Subjekteve private, kërkesë për plotësim dokumentacioni për ushtrimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues.
5. Kërkesë kompanive te transmetimit celular : Nisje të procedurës për t'u pajisur me akt miratimi për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues.
6. Kërkesë kompanive të transmetimit celular paraqitje e vlerësimit nga eksperte të mbrojtjes nga rrezatimi, të njohur nga KMR për stacionet e vendosura në :
 - lagjen Manalat, Gjirokastrë
 - rrugën "Mikel Maruli " Tiranë
 - rrugën "Marubi " pranë Spitalit Ushtarak
7. Kërkesë Agjensisë Kombëtare të Turizmit,për materiale promocioni.
8. Kërkesë komisaritit nr.2, Tiranë, për mbeshtetje në lidhje me sigurinë dhe mbarëvajtjen e seminarit të organizuar në Tiranë.
9. Dërgim raport inspektimi .
10. Përgjigje ankesave të qytetarve në lidhje me antenat e kompanive celulare.
- 11.Mbeshtetje logjistike për ZMR.

- Kthim përgjigje instucioneve si:

1. Inspektoriatit Qendror, Tiranë
2. QSUT
3. Kompanive celulare, AMC,Vodafone,Eagle – Mobile,Plus
4. Avokatit te Popullit
5. Ministria e Shëndetsisë
6. Kompanisë Interas Group
7. Mini Bashkise nr.11, Tiranë
8. Mini Bashkisë Nr.6, Tiranë
9. Ministrisë së Jashtme

Lidhur me çështjet e mbrojtjes nga rrezatimi do të gjeni informacion më të hollësishëm në faqën zyrtare të internetit www.moh.gov.al ose www.ishp.gov.al